REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

Nr 4394 **Prot** **Date** 30 / 12 /**2025**

PROJEKT-UDHËZIM

Nr. 1 **, date** 30 / 12 **/2025**

PËR

"PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR MËNYRËN E PARAQITJES SË APLIKIMIT DHE PROCEDURËN ADMINISTRATIVE PËR NJOHJEN SI POSEDUES JOPRONAR"

Në mbështetje të ligjit nr. 20/2025 "Për paketën e maleve"; ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; si dhe udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkive",

UDHËZOJ:

I.DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitj es së aplikimit/kërkesës dhe procedurën e brendshme administrative që ndiqet nga bashkia pë r njohjen e poseduesve jopronarë në zonat e shpallura si zonë zhvillimi.

2.Ky udhëzues synon të ofrojë udhëzime të qarta dhe të sakta për të gjithë subjektet aplikuese në procesin e paraqitjes së kërkesës për njohjen e tyre si posedues jopronar.

3.Bashkia Devollka si objektiv të saj kryerjen e procedurave administrative në njohjen e subje kteve kërkuese si posedues jopronar në përputhje me parashikimet ligjore të legjislacionit dhe ato që parashikohen në këtë udhëzim duke
u udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, transparencës, objektivitetit dhe eficiencës.

II. PARAQITJA E KËRKESËS

1.Për çdo zonë zhvillimi të shpallur ngrihet grupi teknik i punës, përbërja dhe afati i veprimta risë së të cilës miratohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Grupi i punës do të ndjekë të gjit hë

procesin administrativ, nga paraqitja e kërkesës deri në njohjen e subjektit kërkues si "posedu es jopronar".

2.Grupi i punës ngrihet në varësi të rrethanave të posaçme të secilës zonë të aplikuar.

3.Subjekti paraqet kërkesën e argumentuar me shkrim nëpërmjet aplikimit online në zërin e dedikuar për këtë qëllim, në portalin **e-albania**. Kërkesa duhet të shoqërohet me plan rilevimi të sipërfaqes së poseduar, të hartuar nga një ekspert gjeodet i licensuar.

4.Kërkesa duhet të shoqërohet me një ose më shumë nga dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentacion tatimor që vërteton ushtrimin e aktivitetit ekonomik mbi pasurinë;

b) Fatura të shërbimeve të lidhura me pasurinë si: pagesat për energjinë elektrike, ujë etj.

c) Deklarata/dëshmi të banorëve dhe autoriteteve vendore që vërtetojnë përdorimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë prej të paktën 10 (dhjetë) vitesh;

d) Fotografi, ortofoto ose prova të tjera materiale që vërtetojnë posedimin;

e) Çdo dokument tjetër i cili provon lidhjen e subjektit aplikues me pasurinë.

5.Mungesa e dokumentacionit provues nuk përbën shkak për refuzim, rrëzim të kërkesës apo pezullim të procedurës administrative të njohjes së subjektit kërkues si **"posedues jopronar.**

III. PROCEDURAT E VERIFIKIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESËS

1.Pas regjistrimit të kërkesës, grupi i punës kryen verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në çdo element të tij.

2.Në rast të mungesave të provave shkresore, grupi realizon verifikimin në terren përmes inspektimeve dhe marrjes së deklaratave/dëshmive nga banorë të zonës dhe mban një procesverbal për këtë qëllim.

3.Procesverbali i hartuar nga grupi i punës në kuadër të verifikimit që ai kryen në terren përfs hin të dhëna mbi:

a) Përputhshmërinë e sipërfaqes së rilevuar me gjendjen faktike;

b) Posedimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë prej të paktën 10 (dhjetë) vitesh të pasurisë;

c) Mungesën e pretendimeve nga të tretët mbi sipërfaqen e kërkuar;

d) Informacion mbi gjendjen juridike të pasurisë në bashkëpunim me ASHK, ATP;

e) Informacion për kriteret lidhur me pronën.

4.Nëse pas administrimit të kërkesës dhe verifikimit të kushteve të lidhura me pronën dhe me subjektin kërkues konstatohet se nuk përmbushen një ose disa kritere sipas shkronjës "c", nen i 3 dhe nenit 8 të ligjit 20/2025, bashkia njofton subjektin kërkues dukee informuar atë për pamundësinë e vijimit të procedurës për njohjen e tij si "posedues jopronar".